



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:064575

Datë: 15.05.2019

Numri i dokumentit: 00313713

P.nr.817/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja Ilirjana Hoti, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarit R. K. nga fsh. F. K. Gjakovë, për shkak të veprës penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275/2-1 të KPRK-ës, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë, PP/II .nr.1528/18 të datës 09.11.2018, në shqyrtimin fillestar gjyqësor, të mbajtur më datë **07.05.2019**, në prani të Prokurorit të shtetit N. K., të akuzuarit , të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli ,ndërsa përpilojë me dt. 10.05.2019 këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **R. K.**, nga fsh. F. K. Gjakovë, data e lindjes . . . , i biri i Xh. dhe i nënës L.e gjinisë M., ka te kryer shkollën e mesme, i pa punë , i gjendjes se dobët ekonomike, Shqiptar, shtetas i R. Kosovës ,i pa martuar, me ID . . .

Ë s h t ë f a j t o r

Sepse :

-me dt. 02.10.2018, rreth orës 22.40 min, në Gjakovë Rr". . ."i pandehuri autorizimi ka poseduar narkotik, substancë psikotrope ose analoge te shpallura te rrezikshme nga neni 9 dhe 14 te Ligjit mbi Barnat Narkotike , substanca psikotrope dhe prekosore , ne atë mënyrë qe pas një kontrolli nga njësitë patrullues te policisë ne veturën “. . .” te cilën e drejtonte i pandehuri , është gjetur e fshehur një qese najloni me substancë ne formë bari ngjyre e gjelbër ,e dyshuar për marihuan si dhe një sasi tjetër e te njëjtës substancë është gjetur ne xhepin e setrës se te pandehurit e cila pas testimi ka rezultuar substancë narkotike e llojit marihuan ne peshë prej 2.91 gr.

-me çka ka kryer veprën penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275/2-1 të KPRK-ës,

Andaj Gjykata në bazë te nenit 4,41,43,46,73 të KPRK-ës, dhe nenit 275/2-1 të KPPK-ës, dhe nenit 365 te KPPK-së te akuzuarit i shqipton:

DËNIM ME KUSHTË

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej **6 (gjashtë) muajve** , i cili dënim nuk do te ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës se verifikimit ne afatin prej **1(një) viti** nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale,

Detyrohet i akuzuari qe ti paguajnë shpenzimet në emër të paushallit gjyqësor shumë prej **30,00.-€**, në afat prej **15** ditësh, e krejt këtë pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

Mbikëqyrjen e periudhës verifikuese te dënimit me kusht do ta bene Shërbimi Sprovues i Kosovës Dega në Gjakovë .

Gjykata bazuar ne nenin 275 par.3 të KPRK-ës lidhur me nenin 62 par.2 pika 2.7, të akuzuarit ia shqipton masën e :

MARRJA E SENDEVE

Konfiskohet substanca narkotike e llojit Kanabis ngjyrë e gjelbër e llojit “Marihuan” me peshë 2.91 gr , që është objekt i kësaj vepre penale e sekuestruar me dt. 02.10.2018.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP.nr.1528/18 të datës 09.11.2018, ka akuzuar të akuzuarin R. K. nga Gjakova, për shkak të veprës penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275/2-1 të KPRK-ës.

Gjatë shqyrtimit fillestar gjyqësor të mbajtur me dt.07.05.2019, prokurori i shtetit N. K. , bene leximin e aktakuzës PPnr. 1528/18 të dt.09.11.2018 deklaroi mbetem ne tërësi pranë aktakuzës.

I akuzuari R. K., lidhur me fajësinë thekson se e pranon ne tërësi fajësinë sipas aktakuzës me te cilën pandehet duke i ditur edhe me pare pasojat e pranimi te fajësisë dhe atë ne mënyrë vullnetare dhe pa presion, shtojë se me pranimin e fajësisë në çdo fazë te procedurës jam penduar për veprën e kryer, premtojë se një veprim i tillë nuk do te përsëritet me meqenëse nuk jam konsumues i rregullt, andaj i propozoi gjykatës qe te marr parasyshe rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë ne çdo faze te procedurës, premtimin e shprehur ne gjykate se me nuk do te përsëris vepra penale te natyrës se njëjtë apo te natyrës se ngjashme, gjendjen e dobët ekonomike si dhe faktin se është hera e pare qe kam rënë ndesh me ligjin, te me shqiptoj një dënim me te butë.

Duke u deklaruar lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit Prokurori i shtetit N. K., deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga këtu i akuzuari R. K. pasi qe i njëjti është i vetëdijshëm për pasojat dhe favoret juridike te pranimi te fajësisë dhe se aktakuza ka mbështetje ne provat materiale qe gjenden ne shkresat e lendes, po ashtu konform neni 275/3 KPRK-ës kërkoj ti përcaktohet edhe dënimi plotësues , të konfiskohet substanca narkotike e sekuestruar.

Ne shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari R. K.: **me dt. 02.10.2018, rreth orës 22.40 min,** në Gjakovë Rr”. . .”, i pandehuri autorizimi ka poseduar narkotik, substancë psikotrope ose analoge te shpallura te rrezikshme nga neni 9 dhe 14 te Ligjit mbi Barnat Narkotike , substanca psikotrope dhe prekusore , ne atë mënyrë qe pas një kontrolli nga njësi patrullues te policisë ne veturën “. . .” te cilën e drejtonte i pandehuri , është gjetur e fshehur një qese najloni me substancë ne formë bari ngjyre e gjelbër ,e dyshuar për marihuan si dhe një sasi tjetër e te njëjtës substancë është gjetur ne xhepin e setrës se te pandehurit e cila pas testimi ka rezultuar substancë narkotike e llojit marihuan ne peshë prej 2.91 gr.

Pasi gjykata ka fituar bindjen se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë për veprën penale që i vihet në barrë dhe është bindur se pranimin e ka bërë në baza vullnetare, duke u mbështetur edhe në faktet dhe provat që i përmban propozim akuza, nuk ka gjetur se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore nga neni 326 par.4 te KPP, dhe shqyrtimin gjyqësor e ka përfunduar pa administrimin e provave.

Me rastin e matjes së dënimit ,gjkata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 73 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit .Rrethana rënduese nuk gjeti ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka marrë parasysh pranimin e vullnetshëm të fajësisë nga i akuzuari, sjelljen korrekte të akuzuarit në gjykim , gjendjen e dobët ekonomike të akuzuarit, pendimin e tij, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale si dhe faktin se është hera e parë që ka ra ndesh me ligjin, të cilat rrethana ndikuan që Gjykata ti zbatoi dispozitat e zbutjes së dënimit të parapara me nenin 73 të KPRK-së, Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin me kusht duke ia vërtetuar dënim me burgim në kohëzgjatja prej **6 (gjashtë)** muajve , i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1 (një) viti**, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale , do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 dhe 50 i KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

Vendimi për konfiskimin e substancës narkotike të llojit kanabis (marihuanë), me peshë prej 2,91 gr, që është objekt i kësaj vepre penale e sekuestruar me dt. 02.10.2018 ,u murr komform nenit 275 par.3 të KPRK-ës lidhur me nenin 62 par.2 pika 2.7 nenit 69 te KPRK-ës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor bazohet në dispozitat e nenit 450 par.1dhe 2 nën paragrafi 2.6 te KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,
P. nr.817/18 më datë 07.05.2019**

**Sekretarja juridike,
Flutur Nagavci**

**Gj y q t a r j a,
Ilirjana Hoti**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund te paraqitet ankesë, në afatin prej **15ditësh** ,nga dita e marrjes se tij ne dorëzim ,Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykatë

Numri i lëndës: 2018:064575
Datë: 15.05.2019
Numri i dokumentit: 00313713